



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:275622
Datë: 25.03.2024
Numri i dokumentit: 05500696

C - IV. – 15 –1244

Paditësi:

R Y nga Prishtina, me numër personal., Prishtinë, e të cilën me autorizim e përfaqëson, av.G A nga Prishtina.

Kundër

E paditura:

Agjencia Kosovare e Privatizimit me seli në Prishtinë, Rr. “Dritan Hoxha” nr.55, Lagjja, ”Lakrishtë”, Prishtinë.

Për: Palët ndërgjyqëse.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), me gjykatësin, Agron Hoxhaj, me dt.25.03.2024, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSIDEROHET e tërhequr padia e paditësit, R Ynga Prishtina, dhe atë për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore për padinë e ushtruar.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale në këtë çështje juridike kontestimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Paditësi me dt.30.06.2015, pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ka paraqitur ankesë kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL), PRN173-0372, të dt. 27.05.2015 të Ndërmarrjes Shoqërore (NSh) “NewCo Grand Hotel” Sh.p.k me seli në Prishtinë

në (likuidim), e me të cilin paditëses i është refuzuar kërkesa e tij për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën dhjetor 2011 deri gusht 2012, në shumën prej 2,891.24 €, dhe se paditësi ka kërkuar nga gjykata që të anulohet Vendimi i Autoritetit të Likuidimit, dhe t'i njihet e drejta për marrjen e kompensimit për pagat e pa paguara.

Paditësi e ka titulluar parashtrësën si “ankesë” mirëpo gjykata të njëjtën e konsideron si padi e duke u bazuar në nenin 35 par.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e cila dispozitë bënë trajtimin e barabartë të parashtrësave me të cilat bëhet “*nisja e procedurave*” pran Dhomës së Posaçme, pavarësisht faktit se a quhen padi, kërkesë apo ankesë.

Paditësi, ankesës së tij i'a ka bashkangjitur provat në kopje të tyre : autorizimin, Vendimin e Autoritetit të Likuidimit, PRN173-0372 të dt.27.05.2015, letërnjoftimin, librezën e punës, me nr.217478, kontratën e punës nr.116, të dt.03.04.2007, kërkesën për kompensimin e pagave, njoftimin e dt. 26.03.2012, vendimin e shoqatës sindikale të pavarur të dt.02.04.2012, vendimin e dt.24.04.2012, përgjigjja e AKP-së, në shkresën e dt.24.07.2012, aktvendimi i dt.21.08.2014, listat e papaguara për muajt 12/2011 deri 08/2012

Me dt.22.02.2024, kjo gjykatë me urdhrin e saj, C - IV. – 15 – 1244, ka urdhëruar paditësin që të bëjë pagesën e taksës gjyqësore për padinë e tij në shumën prej 20.00 € e duke e njoftuar se padia e tij, do të konsiderohet e tërhequr nëse brenda afatit të dhënë në këtë Urdhër, ai nuk e paguan taksën gjyqësore për padi/ankesë.

Me dt.27.02.2024, I autorizuari i paditësit, e ka pranuar Urdhrin e kësaj gjykate, C - IV. – 15 – 1244 të dt.22.02.2024 për pagesën e taksës gjyqësore, por i njëjti deri më tani nuk i është përgjigjur gjykatës për të bërë pagesën e taksës gjyqësore për padinë e ushtruar kundër të paditurës, AKP-së me seli në Prishtinë.

Arsyetimi ligjor

Padia e paditësit R Ynga Prishtina, konsiderohet si e tërhequr për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore.

Ne bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit Nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, parashihet se: *''Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë përshtatshmërisht - mutatis mutandis dispozitën përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore''* derisa në nenin 253 par.5 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), që ka të bëjë me mos pagesën e taksës gjyqësore për në një padi, parashihet se: *''Në qoftë së paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr''*. Po ashtu në nenin 5.5.2 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, parashihet se: *''Nëse taksa për padi, e përcaktuar sipas vlerës së kontestit në padi, nuk paguhet deri në datën përfundimtare, edhe pas*

pranimi të vërejtjes për pagesën e saj, në rastet kur nuk ekzistojnë kushtet për lirim të palës nga detyrimi i pagesës, do të zbatohet neni 253 par.5 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, ashtu që do të konstatohet se padia është tërhequr. ”.

Me dt.22.02.2024, kjo gjykatë me Urdhrin e saj, C - IV.-15 – 1244, të dt.22.02.2024, ka urdhëruar paditësin që të bëjë pagesën e taksës gjyqësore për padinë e tij në shumën prej 20.00 € e duke e njoftuar se padia e tij, do të konsiderohet e tërhequr nëse brenda afatit të dhënë në këtë urdhër ai nuk e paguan taksën gjyqësore dhe se paditësit, i është dhënë lejuar afati prej 15 ditësh, që t’ a bëjë pagesën e taksës gjyqësore e sipas vlerësimit të gjykatës, ky është një afat i mjaftueshëm kohor për të kryer pagesën e taksës gjyqësore për padinë e tij dhe se i njëjti, ka për obligim t’ a paguaj taksën gjyqësore e cila aplikohet sipas nenit 6 të Udhëzimit Administrativ, nr.01/2017 të KGJK-së për Unifikimin e Taksave Gjyqësore. Duke qenë se paditësi Urdhri e kësaj gjykate, C - IV. - 15 – 1244 të dt.22.02.2024 për t’ a paguar taksës gjyqësore për padinë e ushtruar përmes të të autorizuarit të tij, e ka pranuar me dt.27.02.2024, mirëpo paditësi brenda afatit të caktuar prej 15 ditësh por edhe as deri në kohën e vendosjes sipas këtij aktvendimi, nuk i është përgjigjur këtij Urdhri për të bërë pagesën e taksës gjyqësore për padinë e tij por as nuk ka provuar se në rastin e tij ekzistojnë kushtet ligjore për lirim nga pagimi i taksës gjyqësore, gjykata, vendosi që padinë e paditësit, t’ a konsideroj si të tërhequr dhe atë për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore.

Shpenzimet Gjyqësore

Në bazë të nenit 62 par.5 të Ligjit nr.06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), gjykata vendosi që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në bazë të nenit 9, dhe 76 par.3 të Ligjit Nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) lidhur me nenin 253 par.5 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK) dhe lidhur me nenin 5.5.2 të Udhëzimit Administrativ (UA) nr.01/2017 të KGJK-së për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS **2022:275622, 25.03.2024**

Gjykatësi,
Agron Hoxhaj

KËSHILLË JURIDIKE :

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme dhe atë brenda **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPSGJK).